



Plani Strategjik 2020-2024

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Rr. e Shkronjave 1, 20000 Prizren
Republika e Kosovës

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

PLANI STRATEGJIK 2020-2024



UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Plani Strategjik

2020-2024

Zhvillojmë të ardhmen

Dhjetor, 2019



SHKURTESAT

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
BE	Bashkimi Evropian
BKI	Bordi Këshilldhënës Industrial
ESG	Standardet Evropiane të Cilësisë
KK	Kuvendi Komunal
KShC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJA	Njësitë Akadematike
PS	Parlamenti Studentor
QKA	Qendra e Karrierës dhe Alumnit
ROK	Rrjeti i Organizatave të Kulturës
TI	Teknologjia e Informacionit

PËRMBAJTJA

Fjala e rektorit

Historiku i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren

1. Themelet e planit strategjik

- 1.1. Misioni
- 1.2. Vizioni
- 1.3. Vlerat
- 1.4. Grupet e interesit

2. Procesi i planifikimit strategjik

- 2.1. Analiza e pozicionimit (SWOT analiza)

3. Objektivat strategjike

- 4.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
- 4.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore
- 4.3. Kontributi në komunitet
- 4.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit
- 4.5. Zhvillimi i infrastrukturës
- 4.6. Digjitalizimi dhe sistemi i integruar i të dhënave
- 4.7. Qëndrueshmëria financiare

4. Zbatimi i planit strategjik

5. Plani i veprimit

6. Plani financiar



FJALA E REKTORIT

Plani Strategjik 2020-2024 i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, është produkt i një procesi gjithëpërfshirës i konsultimit me studentë, personelin akademik e administrativ, organet vendimmarrëse, përfaqësuesit e biznesit, shoqërisë civile dhe pushtetit lokal.

Në këtë plan strategjik janë dizajnuar objektivat institucionale afatmesme dhe afatgjata të Universitetit në përputhje me misionin dhe vizionin e rishikuar. Njëkohësisht, ky plan adreson rekomandimet e grupit të ekspertëve ndërkombëtar të angazhuar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) . Ky Plan strategjik do t'i shërbej organeve drejtuese si udhërrëfyes për zbatimin e projekteve zhvillimore të Universitetit në funksion të përmbushjes së pritshmërive të komunitetit, studentëve dhe pedagogëve për periudhën vijuese.

Objektivat strategjike të këtij plani mëtojnë sigurimin e cilësisë në procesin e edukimit, zhvillimin e punës kërkimore-shkencore, bashkëpunimin dhe kontributin në komunitet, ndërkombëtarizimin dhe rrjetëzimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe digjitalizimin, si dhe qëndrueshmërinë financiare. Përmbushja e këtyre objektivave strategjike përbënë një sfidë për institucionin tonë, por edhe një mundësi për të ndërtuar një qendër ekselente të edukimit dhe hulumtimit e cila i shërben shoqërisë.

Ne si drejtues të Universitetit, jemi të bindur që projeksionet të këtij plani strategjik përbëjnë themelet e një vazhdimësie të suksesit për rajonin e Prizrenit, Republikën e Kosovës e më gjerë.

Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj
Rektor, i Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren



HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK

Ky plan strategjik është hartuar duke u mbështetur në Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, Ligjin 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, Standardet Udhëzuesit e Akreditimit të Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA), Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar, pas një konsultimi gjithëpërfshirës të akterëve të jashtëm dhe të brendshëm. Pjesë e këtij plani është edhe Plani i veprimit dhe Plani financiar.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 31 dhjetor 2019, miratoi Planin Strategjik për vitet 2020-2024. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të Universitetit do të mbështeten dhe udhëhiqen nga ky plan strategjik.

Anëtarët e komisionit të hartimit të planit strategjik

Prof. Asoc. Dr. Ragip Gjoshi, kryetar
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri, anëtar
Prof. Asoc. Dr. Rifat Morina, anëtar
Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj, anëtar
Prof. Asoc. Dr. Halil Kukaj, anëtar
Prof. Asoc. Dr. Isuf Lushi, anëtar
Prof. Asoc. Dr. Halim Bajraktari, anëtar
Prof. Ass. Dr. Shemsi Morina, anëtar
Dr. Sc. Parim Kosova, anëtar
Prof. Ass. Dr. Kushtrim Braha, anëtar
Burim Berisha, anëtar
MSc. Jasmin Jusufi, anëtar
MSc. Ramadan Baraliu, anëtar
Milot Krasniqi, kryetar i Parlamentit Studentor
Prof. Ass. Dr. Ferim Gashi, anëtar (përfaqësues i MASHT)
Veli Ahmetaj, anëtar (përfaqësues i Shoqatave të Biznesit)
Arben Shala, anëtar (përfaqësues i Shoqërisë Civile)

Falënderime dhe mirënjohje

Falenderojmë programin “HERAS” për kontributin e dhënë nëpërmjet konsultave, komenteve dhe sugjerimeve. “HERAS” financohet nga Agjencia Austriake e Zhvillimit, dhe bashkë financohet nga MASHT-i, dhe zbatohet nga konsurciumi “WUS Austria”, “ZSI dhe OeAD”. Njëkohësisht, falenderojmë të gjithë akterët e brendshëm dhe të jashtëm për komentet dhe kontributin e dhënë.

HISTORIKU I UNIVERSITETIT

Universiteti “Ukshin Hoti” u themelua me vendimin nr. 01/87 të Qeverisë së Republikës së Kosovës më datën 09.10.2009, si Universiteti i dytë publik në Republikën e Kosovës. Universiteti filloi me gjeneratën e parë të studentëve në vitin akademik 2010/11, përkatësisht më 01.10.2010. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 30.05.2013 miratoi Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” me seli në Prizren. Universiteti trashëgon përvojën e ish-Shkollës së Lartë Pedagogjike, degë e ndarë e Universitetit të Prishtinës, që funksiononte nga viti 1961, ndërsa më vonë transformohet në Fakultetin e Edukimit, dega në Prizren.

Ideja fillestare për themelimin e Universitetit ka lindur si nevojë imediate e kërkesës së tregut rajonal të Prizrenit për përgatitjen e specialistëve të fushës së arsimit fillor dhe të mesëm, gjuhësi, teknologji informative, biznes e menaxhment ndërkombëtar, agrobiznes, shkenca pyjore, juridik dhe fushat të tjera. Programet studimore janë hartuar në bashkëpunim të ngushtë dhe konsulencë ndërkombëtare, këto programe të studimit janë në koherencë me trendet e fundit të zhvillimit akademik Evropian.

Aktualisht, në vitin akademik 2019/2020 studiojnë 4,027 studentë aktiv të regjistruar. Studentët të cilët vijojnë studimet në këtë Universitet kanë origjinë nga rajoni i Prizrenit, si: Prizreni, Suhareka, Rahoveci, Malisheva dhe Dragashi, dhe rajonet tjera të Republikës së Kosovës. Struktura e moshës së studentëve është kryesisht e re. Prejardhja socio-ekonomike e studentëve të Universitetit është e nivelit mesatar, në përputhshmëri me gjendjen socio-ekonomike të pjesës më të madhe të popullsisë.

Aktualisht, Universiteti përbëhet nga gjashtë fakultete ku organizohen 21 programe të studimeve, në dy nivele (baçelor dhe master). Njëkohësisht, brenda një periudhe afatmesme, Universiteti planifikon të hap edhe programet e studimeve të doktoratës, të këshilluara dhe financuara nga BE-ja. Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, Universiteti është pjesë e projektit ndërkombëtar “DI-PHDICTKES” (The development and implementation of PhD Curricula in ICT for Kosovo Education System), nën udhëheqjen e dy universiteteve: “LNU”, Suedi, dhe “NTNU”, në Norvegji. Po ashtu, në Universitet po zbatohen edhe pesë projekte të ngritjes së kapaciteteve (CTPCIE, CIEPCBHE, SMART4ALL, QUADIC, TI kabineti) me përkrahjen e donatorëve të huaj nga BE-ja, SHBA-të dhe Turqia. Programet e studimit i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm të cilësisë. Për këtë qëllim, Universiteti ka ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë, në të gjitha nivelet.

Universiteti, përveç programeve studimore në gjuhën shqipe, i ofron studentëve edhe programet e studimit në gjuhën turke dhe boshnjake. Diversiteti gjuhësor i programeve studimore e bën Universitetin unik, krahasimisht me Universitetet tjera në Kosovë.

Universiteti ka themeluar Qendrën e Karrierës dhe Alumnit (QKA), e cila ka në fokus krijimin e urës lidhëse ndërmjet punës akademike dhe tregut të punës, përmes orientimit, këshillimit dhe zhvillimit profesional të studentëve, përkatësisht ngritjes profesionale të studentëve të diplomuar dhe përafrimit të tyre me tregun e punës.

Stafi Akademik i Universitetit, ka përgatitje të lartë akademike dhe integritet të lartë etik dhe profesional. Ata marrin pjesë në

mënyrë aktive në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori kërkimore-shkencore. Po ashtu, Stafi Akademik i Universitetit është edhe bashkë-organizator i konferencave shkencore rajonale dhe ndërkombëtare. Për të avancuar punën kërkimoro-shkencore, në kuadër të njësive akademike të Universitetit, parashihet themelimi i Instituteve kërkimoro-shkencore.

Universiteti ofron shërbime këshilluese dhe ekspertiza profesionale për komunitetin e biznesit dhe organizatat tjera publike dhe private. Këto shërbime ofrohen në kuadër të Qendrës për Inovacion dhe Punësim (T2P). Kjo qendër funksionon në kuadër të Universitetit, me përkrahjen e projektit Erasmus+ (BE). Kontributi në komunitet i Universitetit është jetik për zhvillimin e tij. Për këtë qëllim, janë themeluar Bordet Këshillëdhënëse Industriale (BKI), në kuadër të secilës njësi akademike. BKI i shërben njësive akademike të Universitetit për komunikim dhe ndërveprim me komunitetin rajonal të biznesit dhe më gjerë. Për më tepër, Universiteti do të kontribuoj aktivisht me kapacitet e veta akademike në përmbushjen e misionit të “Parkut Gjermano-Kosovar të Inovacionit dhe Trajnimeve” në qytetin e Prizrenit. Misioni i themelimit të këtij parku parasheh bashkëpunimin me njësitë akademike (FSHK dhe FSHJM).

Kampusi i Universitetit gjendet në afërsi të parkut të qytetit të Prizrenit. Infrastruktura e Universitetit përbëhet nga: dyzetë salla mësimi, tre amfiteatre, dyzetë e shtatë zyre për stafin akademik dhe administrativ me një sipërfaqe të përgjithshme të infrastrukturës prej rreth 14,820 m². Objekti i Universitetit posedon Bibliotekën Universitare e cila ka një fond prej mbi 60.000 mijë tituj

librash në gjuhën shqipe, angleze, gjermane, turke, boshnjake si dhe në gjuhë të tjera. Kabinetet e Informatikës dhe IT-së, janë gjithashtu pjesë e rëndësishme e infrastrukturës së Universitetit.

Përfundimisht, Universiteti ka përditësuar kornizën legislative dhe funksionale të saj në përputhshmëri të plotë me standardet e manualit të akreditimit të AKA dhe standardet e cilësisë të ESG.

Fakultetet dhe programet e studimit të Universitetit

Nr	Fakulteti	Programet studimore
1.	Fakulteti Ekonomik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Administrim Biznesi (BSc) ▪ Menaxhment Ndërkombëtar (BSc) ▪ Kontabilitet dhe Auditim (MSc) ▪ Administrim Biznesi (MSc)
2.	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Teknologji Informacioni dhe Telekomunikimi (AL, TR, BS) (BSc) ▪ Dizajn Softueri (BSc) ▪ Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi (MSc)
3.	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Agrobiznes (BSc) ▪ Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit (BSc)
4.	Fakulteti Juridik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Juridik (LLB)
5.	Fakulteti i Edukimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Programi Parashkollor (shqip, turqisht dhe boshnjakisht) (BA) ▪ Programi Fillor (AL, TR, BS) (BA)
6.	Fakulteti i Filologjisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (BA) ▪ Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA) ▪ Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (BA)

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

Vendimet strategjike të Universitetit bazohen në trashëgiminë akademike, historike, traditën biznesore dhe tregtare të rajonit të Prizrenit si dhe veçoritë e diversitetit kulturor dhe gjuhësor të saj.

- Universiteti është **institucion publik** i konsoliduar i arsimit të lartë, me një trashëgimi akademike pesëdhjetë e tetë vjeçare nga Shkolla e Lartë Pedagogjike;
- Kampusi universitar i Universitetit gjendet në **qytetin e Prizrenit**. Makromjedisi i Universitetit është ndërtuar mbi vlerat e trashëgimisë së pasur historike, kulturore, shkencore dhe biznesore të rajonit të Prizrenit;
- Ky qytet njihet zyrtarisht si **kryeqytet historik i Republikës së Kosovës** (Ligji nr. 06L/-012). I njohur ndryshe si selia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe si djep i historisë, artit dhe shkencës;
- Historikisht, qyteti i Prizrenit është i njohur si **qendër e rëndësishme administrative, biznesore dhe tregtare**;
- Përveç vlerave historike, qyteti i Prizrenit, njihet edhe për **multietnicitet dhe trashëgimi kulturore** jo vetëm në Republikën e Kosovës, por edhe me gjerë;
- Makromjedisi në të cilin vepron Universiteti karakterizohet me një **diversitet gjuhësor, etnik dhe fetar**. Ky diversitet paraqet një vlerë të shtuar për Universitetin;
- Universiteti ka **mbulueshmëri demografike dhe gjeografike përfaqësuese**. Rajoni i Prizrenit mbulon 21.9% të sipërfaqes

së përgjithshme të Republikës Kosovës dhe ¼ e popullsisë me 403.846 banorë;

- Komuniteti në të cilin zhvillon aktivitetin e vet Universiteti njihet për **tradiçën në biznes**. Historikisht, ky komunitet ka kontribuar në zhvillimin e pëgjithëshem ekonomik rajonal, kombëtar dhe më gjerë;
- Universiteti ka **gjashtë fakultete dhe njëzetë e një programe studimore**, në nivelin baçelor dhe master;
- Universitetit ka **standardizuar infrastrukturën dhe hapësirat për studim** në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ;
- Universiteti ka ndërkombëtarizuar aktivitetet e saj nëpërmjet **rrjetëzimit ndërkombëtar** duke nënshkruar një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të huaja dhe organizata të tjera;
- Universiteti ka konsoliduar **bibliotekën universitare dhe qasjen në biblioteka elektronike** duke e pasuruar atë me një fond të madh të librave për nevoja të programeve studimore dhe për punë kërkimore-shkencore;
- Universiteti ka ndërtuar një **lidhje të ngushtë me komunitetin e biznesit**. Për këtë qëllim ka themeluar Bordet Këshilldhënëse Industriale (BKI) brenda njësisë akademike.

1.1. Misioni

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, është institucion akademik e konkurrues i orientuar në ofrimin e edukimit cilësor duke zhvilluar kërkime shkencore dhe duke kontribuar në inovacion, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

1.2. Vizioni

Universiteti ndërton vizionin duke u mbështetur në parimin e vlerave edukativo-kërkimore, përparësive krahasuese të diversitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor, me qëllim të krijimit të një qendre të ekselencës akademike e cila do t'i shërbejë studentëve, hulumtuesve dhe shoqërisë në fushat e TI, agrobiznesit dhe mjedisit, menaxhmentit dhe administrimit të biznesit, drejtësisë, gjuhësisë dhe edukimit.

1.3. Vlerat

Vlerat mbi të cilat është hartuar Plani Strategjik 2020-2024 udhëhiqet në drejtim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të saj. Universiteti promovon vlerat universale, grupore dhe individuale si vijon:

- **Liria e shprehjes dhe punës akademike-shkencore** në mënyrë që të sigurohet shprehja e mendimit ndryshe;
- **Ngritja e vazhdueshme e cilësisë** në procesin e edukimit dhe punës kërkimoro-shkencore;
- **Konkurrentshmëria** brenda Universitetit si vlerë e shtuar zhvillimit akademik dhe shkencor;
- **Transparenca** dhe liria e shprehjes e mendimit kritik;
- **Kohezioni me kërkesat e tregut** të punës;
- **Meritokracia** si vlerë universale e njohjes së kontributeve individuale dhe grupore;
- **Diversiteti linguistik, etnik dhe kulturor** si vlerë e shtuar burimore nga makromjedisi i rajonit të Prizrenit;
- **Barazia sociale dhe gjinore** si vlerë e fuqizimit të shtresave sociale të marginalizuara dhe fuqizimit të rolit të gruas;
- **Qëndrueshmëria financiare** nëpërmjet diversifikimit të burimeve për financimin e punës së Universitetit;
- **Bashkëpunimi i ngushtë me komunitetin e biznesit** në nivel të rajonit të Prizrenit, nacional dhe më gjerë.

1.4. Palët e interesit

Universiteti e planifikon zhvillimin e saj strategjik për periudhën 2020-2024 duke u mbështetur në ndërveprimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me palët e interesit të cilët janë pjesëmarrës aktiv të zhvillimit brenda dhe jashtë mjedisit të Universitetit.

STAFI AKADEMIK

Stafi akademik përbënë bartësit kryesorë të procesit edukativ dhe aktiviteteve kërkimoro-shkencore. Ky grup i interesit përfaqësohet nga profesorët e rregullt, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencor. Stafi akademik i rregullt kategorizohet sipas thirrjes akademike në Prof. Asoc. Dr., Prof. Ass. Dr. dhe Ass.

STAFI ADMINISTRATIV DHE TEKNIK

Stafi administrativ dhe teknik përbënë palët e brendshme të interesit të cilët kryejnë funksionet operative të Universitetit.

- Sekretari i përgjithshëm
- Zyrtarët e administratës
- Bibliotekistët
- Personeli teknik

MENAXHMENTI I UNIVERSITETIT

Menaxhmenti i Universitetit përbënë organet udhëheqëse që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës edukativo-kërkimore.

- Këshilli Drejtues
- Senati
- Rektori
- Prorektorët
- Dekanet / Prodekanet / Shefat e katedrave

STUDENTËT

Studentët janë përfituesit më të mëdhenjë të procesit të krijimit dhe bartës të dijes. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët kosovar dhe ata ndërkombëtarë, përfshirë këtu studentët e rregullt dhe studentët në marrëdhënie pune.

ALUMNI (STUDENTËT E DIPLOMUAR)

Alumni janë studentët e diplomuar të cilët vazhdojnë të gëzojnë shërbimet e Universitetit si dhe të kontribuojnë në lidhjen e urave të komunikimit të Universitetit me komunitetin e jashtëm. Ky grup i interesit mund të krijojë komunitetin e vet pas përfundimit të studimeve.

KOMUNITETI I BIZNESIT

Komuniteti i biznesit është palë strategjike e interesit e cila përbëhet nga përfaqësuesit e industrisë dhe bizneset lokale dhe ato ndërkombëtare. Universiteti bashkëpunon ngushtë me komunitetin e biznesit nëpërmjet Bordeve Këshilldhënëse Industriale (KBI) të njësive akademike.


AUTORITETI QEVERITAR LOKAL DHE QENDROR

Autoriteti qeveritar në nivel lokal dhe qendror përbënë një aktor të rëndësishëm në zbatimin e planit strategjik. Në këtë kuadër përfshihen përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të rajonit të Prizrenit, MASHT, Ministria e Financave etj.


KOMUNITETI I JASHTËM AKADEMIK DHE SHKENCOR

Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik, duke përfshirë këtu Shkollat e Mesme, Universitet simotra brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, Institutet kërkimore-shkencore etj.


Numri i studentëve aktiv (të regjistruar)




Struktura gjinore e studentëve (të regjistruar)




Studentët sipas qytetit të lindjes (2019/2020)




Numri i studentëve të diplomuar (2010-2019)




Shkalla e braktisjes (studentët aktiv/studentët e ç'regjistruar)




Personeli akademik i rregullt (2019)



Personeli akademik sipas gjinisë (2019)



Stafi mbështetës administrativ dhe teknik (2019)



2. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Procesi i planifikimit strategjik të Universitetit ka filluar me **vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm** duke marrë për bazë rekomandimet e Grupit të Ekspertëve Ndërkombëtar për Akreditim dhe KShC. Planifikimi strategjik ka përfshirë një proces konsultativ gjithëpërfshirës me të gjitha palët e interesit, përfshirë këtu edhe zbatimin e një ankete me këto palë të interesit.

Plani Strategjik 2020-2024 paraqet një rishikim thelbësor të planit strategjik paraprak dhe mbështetet në **qasjen evolutive të objektivave strategjike** të Universitetit, në përputhje me kërkesat e përditësuara akademike, sociale dhe tregut të punës.

Universiteti synon **ngritjen e vazhdueshme të cilësisë**, nëpërmjet promovimit të sinergjisë midis procesit të edukimit dhe punës kërkimore-shkencore bazuar në përvojat e mira Evropiane.

Në këtë drejtim, ky Plan strategjik **identifikon objektivat strategjike të zhvillimit** të Universitetit për periudhën afatmesme 2020-2024 të zhvillimit.

Plani Strategjik përfshinë edhe **planin e veprimit** në kuadër të të cilit planifikohen aktivitetet, masat, afatet kohore të zbatimit, bartësit dhe kostot e financimit.

Në kuadër të Planit Strategjik 2020-2024, Universitetit ka identifikuar **7 objektiva strategjike** që inkorporojnë në vete: sigurimin e cilësisë në edukim, punën kërkimore-shkencore, kontributin në komunitet, procesin e ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit, zhvillimin e infrastrukturës, digjitalizimin e sistemit të integruar të dhënave si dhe qëndrueshmërinë financiare.

Fuqitë

- Programe cilësore dhe atraktive të studimit
- Kredencialet akademike të standardizuara me ato të BE
- Fokusi në zhvillimin e shkathtësive të studentëve
- Kosto e përballueshme e studimit për studentë
- Kampusi në qytetin me traditë akademike dhe kulturore
- Komunikimi dhe ndërveprimi intensiv student-profesor
- Diversiteti etnik, kulturor dhe gjuhësor i studentëve
- Këshillimi i personalizuar për studentë
- Liria e fjalës dhe e të shprehurit

- Zgjerimi i rrjetëzimit me universitete rajonale dhe ndërkombëtare
- Lokacioni atraktiv lokal (trashëgimia historike, tradita biznesore)
- Avancimi i punës praktike me partnerët e komunitetit të biznesit
- Avancimi i shërbimeve të konsulencës dhe ekspertizave profesionale
- Ofrimi i kurseve (moduleve) online për studentët e huaj
- Hapja e programeve studimore në gjuhën angleze
- Hapja e programeve studimore të doktoratës
- Përfitimet e komunikimit me alumni (studentët e diplomuar)
- Gjenerimi i burimeve vetanake financiare dhe donacioneve

Mundësitë

Dobësitë

- Numri i kufizuar i programeve studimore
- Mungesa e programeve të doktoratës
- Marrëdhëniet e kufizuara me komunitetin e jashtëm
- Kufizimi i mobilitetit për shkak të regjimit të vizave
- Përkrahja e kufizuara financiare për punën kërkimore
- Produktiviteti i ulët i punës kërkimore-shkencore
- Infrastruktura e vjetërsuar (IT, kabineti i informatikës etj.)

- Konkurrenca jolojale nga kolegjet private
- Ndryshimet demografike dhe emigrimi i të rinjve
- Kufizimet buxhetore të financimit të projekteve
- Akreditimi institucional i universitetit
- Qasja e kufizuar në tregun Evropian të punës
- Shkalla relativisht e ulët e punësimit të rinjëve
- Adaptimi me trendet e reja të teknologjisë
- Fluktuimi i stafit akademik në institucione tjera

Rreziqet

3. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Plani Strategjik i Universitetit 2020-2024 ndërtohet në kornizën e 7 (shtatë) objektivave strategjike:

- Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore;
- Kontributi në komunitet;
- Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit;
- Zhvillimi i infrastrukturës;
- Digjitalizimi dhe sistemi i integruar i të dhënave; dhe
- Qëndrueshmëria financiare

Këto objektiva strategjike zbërthehen në rezultatet e pritura për Universitetin.

Objektivat strategjike

Planit Strategjik 2020-2024 ka identifikuar këto objektiva strategjike:



3.1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në kuadër të këtij objekti strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 1.1:** Sigurimi, monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë;
- **Rezultati i pritur 1.2:** Përsosmëria e proceseve dhe procedurave për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë;
- **Rezultati i pritur 1.3:** Avancimi i programeve ekzistuese dhe hapja e programeve të reja studimore në pajtim me nevojat e tregut të punës;
- **Rezultati i pritur 1.4:** Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies me staf të ri akademik;
- **Rezultati i pritur 1.5:** Avancimi profesional i stafit akademik;
- **Rezultati i pritur 1.6:** Fuqizimi i rolit të studentëve në vendimmarrje;
- **Rezultati i pritur 1.7:** Transparenca e organeve të vendimmarrjes;
- **Rezultati i pritur 1.8:** Përkrahja e aktiviteteve studentore;
- **Rezultati i pritur 1.9:** Përmirësimi i shërbimeve për studentë;
- **Rezultati i pritur 1.9:** Përkrahja e studentëve të dalluar me bursa.

3.2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Në kuadër të këtij objekti strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 2.1:** Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve kërkimore-shkencore;

- **Rezultati i pritur 2.2:** Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe masave nxitëse për promovimin e punës kërkimore-shkencore;
- **Rezultati i pritur 2.3:** Pjesëmarrja aktive e stafit akademik në kongrese, konferenca, seminare dhe punëtori ndërkombëtare;
- **Rezultati i pritur 2.4:** Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në punën kërkimore-shkencore;
- **Rezultati i pritur 2.5:** Rritja e numrit të punimeve shkencore të botuara në revista me renome ndërkombëtare (të indeksuara në Web of Science (WOS) dhe Scopus);
- **Rezultati i pritur 2.6:** Organizimi i konferencave shkencore në bashkëpunim me partnerët strategjik ndërkombëtar;
- **Rezultati i pritur 2.7:** Organizimi i Shkollës Verore.

3.3. Bashkëpunimi dhe kontributi në komunitet

Në kuadër të këtij objekti strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 3.1:** Thellimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet bashkëpunimit me Pushtetin Lokal dhe Bordet Këshilldhënëse Industriale (BKI) të njësive akademike dhe palët tjera të interesit;
- **Rezultati i pritur 3.2:** Bashkëpunimi me komunitetin arsimor, kulturor, afarist, Alumnin (të diplomuarit) dhe palët tjera të interesit në hartimin e programeve studimore në harmoni me kërkesat e tregut;
- **Rezultati i pritur 3.3:** Bashkëpunimi me komunitetin në funksion të zhvillimit të praktikës profesionale të studentëve;

- **Rezultati i pritur 3.4:** Ofrimi i shërbimeve e i projekteve vullnetare profesionale për nevojat e komunitetit;
- **Rezultati i pritur 3.5:** Organizimi i fushatave promovuese dhe trajtimi i Universitetit si organizatë e veçantë buxhetore.

3.4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit

Në kuadër të këtij objektivi strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 4.1:** Ndërkombëtarizimi i stafit akademik dhe i studentëve;
- **Rezultati i pritur 4.2:** Ndërkombëtarizimi i kurrikulave dhe programeve të studimit;
- **Rezultati i pritur 4.3:** Ndërkombëtarizimi i kërkimit;
- **Rezultati i pritur 4.4:** Anëtarësimi në asociacione ndërkombëtare dhe standardizimi i cilësisë;
- **Rezultati i pritur 4.5:** Rrjetëzimi akademik dhe kërkimor ndërkombëtar.
- **Rezultati i pritur 4.6:** Profilizimi rajonal dhe ndërkombëtar.

3.5. Zhvillimi i infrastrukturës

Në kuadër të këtij objektivi strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 5.1:** Transformimi dhe adaptimi teknologjik i infrastrukturës;
- **Rezultati i pritur 5.2:** Përmirësimi i infrastrukturës në biblioteka dhe rritja e fondit të titujve të librave;
- **Rezultati i pritur 5.3:** Avancimi i teknologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive të studentëve;
- **Rezultati i pritur 5.4:** Përshtatja e sallave të mësimit me metodat e reja të mësimdhënies;

- **Rezultati i pritur 5.5:** Përmirësimi i infrastrukturës;
- **Rezultati i pritur 5.6:** Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe shërbimeve psikologjike për studentë;
- **Rezultati i pritur 5.7:** Krijimi i kushteve infrastrukturore për personat me nevoja të veçanta.

3.6. Digjitalizimi dhe sistemi i integruar i të dhënave

Në kuadër të këtij objektivi strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 6.1:** Transformimi teknologjik i infrastrukturës sipas ciklit jetësor (zyrat, klasat e mësimit, kabinetet, biblioteka, korridoret dhe oborri);
- **Rezultati i pritur 6.2:** Digjitalizimi i procesit të kontrollit të vijueshmërisë së mësimdhënësve dhe studentëve (sistemi dixhital i prezencës);
- **Rezultati i pritur 6.3:** Veglat e mësimdhënies të bazuara në teknologji (smartboardet, softverët e licencuar dhe hardverët, projektorët dhe pajisjet tjera);
- **Rezultati i pritur 6.4:** Krijimi i një sistemi të integruar i të dhënave për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë (Zgjerimi i shërbimeve të sistemit SMU-SEMS me pyetësor dhe raportet e pyetësorëve);
- **Rezultati i pritur 6.5:** Sigurimi i shërbimeve mbështetëse për komunikim (telefonja fikse, shërbimi i rrjetit (IT) – shërbimi me tel dhe pa tel, shërbimi i shtypjes, kopjimit, skanimit, shërbimet e përbashkëta, shërbimet speciale).

3.7. Qëndrueshmëria financiare

Në kuadër të këtij objekti strategjik Universiteti ka përcaktuar këto rezultate të pritura:

- **Rezultati i pritur 7.1:** Projektet e përbashkëta me komunitetin lokal të biznesit;
- **Rezultati i pritur 7.2:** Projektet e përbashkëta kërkimoroshkencore me partnerët strategjik kombëtar dhe ndërkombëtar;
- **Rezultati i pritur 7.3:** Gjenerimi i të hyrave vetanake nga shërbimet profesionale dhe konsulencës;
- **Rezultati i pritur 7.4:** Të hyrat nga pagesat e studentëve.

4. ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK

Për zbatimin e Planit Strategjik 2020-2024, Universiteti do të themeloj një **këshill mbikqyrës** i cili do të kujdeset për zbatimin të këtij plani strategjik.

Këshilli mbikqyrës do të organizojë rishikimin vjetor të përmbushjes së objektivave të Planit Strategjik. Ky këshill do të ketë përbërje të përgjithshme, respektivisht përbëhet nga

- Kryetari i Këshillit Drejtues të Universitetit,
- Rektori i Universitetit,
- Dekanët e njësive akademike të Universitetit,
- Dy përfaqësues të Parlamentit Studentor,
- Përfaqësuesi i Bordit Këshilldhënës Industrial (BKI),
- Përfaqësuesi i MASHT-it, dhe
- Përfaqësuesi i KK Prizren.

Kampusi i Universitetit

Infrastruktura e Universitetit



25,000 m²

Kampusi universitar

14,820 m²

Hapësira e infrastrukturës

1,701m²

4 Amfiteatro

3,068m²

40 Salla të mësimit

527 m²

3 Biblioteka

476 m²

9 Laboratore

356 m²

3Kabinete të informatikës

1,423 m²

47 zyra administrative dhe stafit akademik

7,269 m²

Hapësira ndihmëse

5. PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Rezultatet e pritura	Aktivitetet	Masat	Strukturat përgjegjëse	Afati kohorë	Buxheti (Euro) / Kodi buxhetor
Objektivi strategjik 1: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie						
1.1.	Sigurimi, monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Miratimi i Rregullores për sigurimin e cilësisë; ▪ Themelimi dhe funksionalizimi i Komisionit qendror për sigurim të cilësisë; ▪ Avancimi i burimeve njerëzore për procesin e sigurimit të cilësisë, duke përfshirë zgjerimin e kapaciteteve të Zyrës për sigurimin e cilësisë; ▪ Monitorimi dhe kontrolli i procesit edukativ; ▪ Ofrimi i kurseve/moduleve online. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Marrja e vendimit nga Senati; ▪ Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies; ▪ Trajnimi i vazhdueshëm i strukturave për sigurim të cilësisë me pjesëmarrje në aktivitete dhe trajnime të organizuara brenda dhe jashtë vendit; ▪ Vlerësimi i stafit akademik të rregullt dhe të angazhuar sipas proceseve dhe procedurave të parapara në Rregulloren për sigurimin e cilësisë. 	Rektorati, Senati, Zyra për Sigurimin e Cilësisë, Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë, Komisioni për Sigurimin e Cilësisë në nivel fakulteti.	2020-2024	180,000 C-1340
1.2.	Përsosmëria e proceseve dhe procedurave për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Monitorimi dhe kontrolli i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe mësimnxënies. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerësimi nga studentët; ▪ Vlerësimi ndërkolegial; ▪ Vlerësimi nga dekani; ▪ Raporti për publikimet shkencore dhe pjesëmarrja në konferenca; ▪ Raporti për kontributin për universitetin dhe kontributin në shoqëri. 	Rektorati, Senati, Zyra për Sigurimin e Cilësisë, Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë, Komisioni për Sigurimin e Cilësisë në nivel fakulteti.	2020-2024	20,000 C-13410

1.3.	Avancimi i programeve ekzsituose dhe hapja e programeve te reja studimore në pajtim me nevojat e tregut të punës	<ul style="list-style-type: none"> Avancimi i programeve studimore ekzistuese; Hapja e programeve të reja studimore (të profilizuara) sipas kërkesës së tregut dhe konsultimeve gjithpërfshirëse me palët e interesit; Krijimi i kornizës rregullative për miratimin dhe hapjen e programeve të reja studimore; Themelimi i komisionit (të Universitetit dhe njërive akademike) për vlerësimin e arsyeshmërisë së programeve të reja studimore; Prioritet i kushtohet hapjes së programeve të reja studimore në gjuhën Angleze. 	<ul style="list-style-type: none"> Rishikimi dhe avancimi i kurrikulave të programeve studimore ekzistuese; Hartimi i studimit të arsyeshmërisë për hapjen e programet e reja studimore; Konsultimi dhe diskutimi i programit të ri studimor me palët e interesit; Miratimi i programit të ri studimor nga Këshilli i njësisë akademike dhe emërimi i bartësve të programeve studimore; Prezantimi i arsyeshmërisë së programeve studimore nga bartësit e programeve të reja studimore para Senatit të Universitetit; Hartimi i Raportit të Vetëvlerësimit (RVV) për programet e reja studimore. 	Rektorati, Senati, Këshillat e njërive akademike, Komisioni i Universitetit për miratimin e programeve studimore, BKI, Zyra për Sigurimin e Cilësisë.	2020-2024	360.000 C-13410
1.4.	Rritja e kapaciteteve të mësimdhënies me staf akademik	<ul style="list-style-type: none"> Rekrutimi i stafit të ri akademik (profesorëve të rregullt dhe asistentëve). 	<ul style="list-style-type: none"> Komisionet recensuese; Komisionet e ankesave; Vendimi i Senatit. 	Rektorati, Senati, Komisionet recensuese dhe të ankesave.	2020-2024	800,000 C-13410
1.5.	Avancimi profesional i stafit akademik	<ul style="list-style-type: none"> Formimi i Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie; Organizimi i trajnimeve për mësimdhënie dhe mësimnxënie i stafit akademik. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e stafit akademik në trajnime profesionale; Edukim i Vazhdueshëm Profesional (EVP) 	Këshilli drejtues, Rektorati, Senati, Zyra për Sigurimin e Cilësisë., Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie.	2020-2024	80,000 C-13410
1.6	Fuqizimi i rolit te studentëve në vendimmarrje	<ul style="list-style-type: none"> Rritja e shkallës së përfshirjes së studentëve në organet vendimmarrëse të Universitetit. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e studentëve në Këshill Drejtues, Senat, Këshill të njërive akademike si dhe në komisionet e themeluara nga Këshilli Drejtues dhe Senati. 	Këshilli Drejtues, Rektorati, Senati, Dekanati; Këshillat e fakulteteve.	2020-2024	16,000 C-13460

1.7	Transparenca e organeve vendimarrëse	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Publikimet në web-faqet e njësive akademike dhe të Universitetit; ▪ Publikimi periodik i gazetës së Universitetit (4 mujore). 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Publikimet në kohe reale të vendimeve, rregulloreve, dokumenteve zyrtare si dhe njoftimeve për ngjarjet në web-faqen e Universitetit; ▪ Dizajnimi, zhvillimi dhe postimi i web-faqes së Universitetit; ▪ Pagesa e domenit dhe siguria. 	Këshilli Drejtues, Rektorati, Dekanati, Zyra e komunikimit.	2020-2024	40,000 C-14220
1.8	Përkrahja e aktiviteteve studentore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Hartimi i agjendës vjetore të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtë kurrikulare; ▪ Dizajnimi, zhvillimi dhe postimi i web-faqes së PS; ▪ Pagesa e domenit dhe sigurisë për web-faqen e PS. ▪ Publikimi periodik i revistës studentore. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizimi i aktiviteteve studentore, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> • garat sportive, • koncerte artistike, • recitale, • konferenca studentore, • panairin e punës, • teatro, • vizita studimore në institucione të ndryshme, • ekspedita dhe ekskursione studimore, • trajnime për studentët, • java e projekteve, • informimi dhe orientim profesional. 	Këshilli Drejtues, Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA), Parlamenti Studentor.	2020-2024	70,000 C13-460
1.9	Përmirësimi i shërbimeve për studentë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Trajnime për zyrtarët e shërbimeve studentore; ▪ Trajnime për zyrtarët e administratës qendrore të rektoratit. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e administratës për shërbimet studentore në funksion të adaptimit teknologjik dhe funksional; ▪ Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e administratës qendrore të rektoratit, në funksion të adaptimit teknologjik funksional. 	Rektorati, Zyra e Personelit.	2020-2024	30,000 C-13460

1.10	Përkrahja e studentëve të dalluar me bursa	<ul style="list-style-type: none"> Ndarja e bursave për studentët e dalluar në nivelin e studimeve baçelor dhe master. 	<ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i kritereve për dhënien e bursave. 	Këshilli Drejtues, Parlamenti Studentor.	2020-2024	400,000
Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore						
2.1.	Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve të kërkimore-shkencore	<ul style="list-style-type: none"> Themelimi i Instituteve kërkimore-shkencore. 	<ul style="list-style-type: none"> Marrja e vendimit nga Këshilli Drejtues (KD) për kornizën ligjore mbi themelimin e Instituteve; Hartimi i Rregulloreve për funksionimin e Instituteve; Ndarja e buxhetit për funksionalizimin e Instituteve; Krijimi i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve të Instituteve; Pajisja me inventar dhe teknologjinë e nevojshme dhe certifikimi i tyre; Rekrutimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm shkencor. 	Këshilli Drejtues, Rektorati, Senati, Këshillat e Fakulteteve, Këshilli Shkencor, Zyra e financave.	2020-2024	80,000 C-13410
